

I. Informacione për azilkërkues me një lejim qëndrimi

1. Për çfarë ju nevojitet juve një lejë për zënie me punë?

për çdo punë jo si i vetëpunësuar në një marrëdhënie pune për mësimin e një profesioni në një ndërmarrje për praktikant më të shumta

2. Si dhe kur mund të merrni ju një lejë për zënie me punë?

2.1 Ju nuk jeni ende që prej 3 muajsh në Gjermani

Në këtë kohë është e ndaluar, të punohet. Prandaj qëndron në lejimin tuaj të qëndrimit:

„Veprimtaria e punës nuk lejohet“.

2.2 Ju jeni që prej 3 muajsh, por ende jo më gjatë se 15 muaj në Gjermani

Në këtë kohë lejohet që ju të punoni dhe mund të merrni një lejë për zënie me punë.

Në lejimin tuaj të qëndrimit në këtë kohë qëndron:

„Zënia me punë me lejen e autoritetit për të huajt e lejuar“.

Pra duhet të jenë të përmbushura kushte paraprake të caktuara.

Çfarë duhet të bëhet?

Së pari ju duhet të gjeni një punëdhënës, i cili dëshiron t'ju vendosë juve në punë. Pastaj ju për këtë vend pune duhet të bëni kërkesë tek një autoritet për të huajt për një lejë për zënie me punë.

Punëdhënësi duhet për këtë të plotësojë një formular. Formularin ju duhet ta dorëzoni tek autoriteti për të huajt, nëse ju bëni kërkesë atje për një lejë zënie me punë.

Autoriteti për të huajt e dërgon kërkesën si rregull për tek **Agjentura Federale e Punës**. Kjo shqyrton nga ana tjetër si më poshtë:

a. Shqyrtim me përparësi

Këtu sqarohet, nëse punonjës/e të tjerë/a (gjermanë/ ose të huaj/a, të cilët lejohet të punojnë kudo) dëshirojnë të duan këtë punë të gjetur prej jush dhe janë të përshtatshëm për këtë.

KUJDES: nëse ju keni përfunduar një studim ose formim profesional dhe përfundimi është njohur në Gjermani, ky shqyrtim mund të bjerë.

b. Shqyrtimi i kushteve të punës

Gjatë kësaj do të sqarohet, nëse në rast të vendit të punës së ofruar ndaj jush zbatohen të gjitha ligjet dhe rregullat (p.sh. për kohën e punës) dhe nëse rroga, të cilën merrni ju, i përgjigjet po ashtu rrogës së përcaktuar.

c. Ndalimi i punës së huazuar

Do të sqarohet, nëse vendi i punës suaj është "punë e huazuar". Nuk lejohet që ju të ushtroni punë të huazuar.

Për këtë shqyrtim Agjentura Federale e Punës ka **2 javë kohë**.

Nëse Agjentura Federale e Punës miraton ose nuk përgjigjet (!), Autoriteti për të huajt do t'ju japë juve lejen e zënies me punë për këtë vend pune. **Kujdesuni ju për këtë**, që kjo të transmetohet nga autoriteti për të huajt edhe në lejimin tuaj të qëndrimit.

Nëse Agjentura Federale e Punës nuk miraton ose ju nuk merrni megjithatë një lejë për zënie me punë, autoriteti për të huajt është i detyruar, t'ju njoftojë juve **me shkrim** shkaqet e refuzimit. Kundër kësaj ju mund të paraqisni brenda një afati të caktuar mjetin ligjor të ankimit; merrni ju për këtë këshillë në një vend këshillimi.

2.3 Ju jeni tanimë që prej 15 muajsh, por jo ende 4 vjet në Gjermani.

Këtu mbetet pothuajse çdo gjë, si në kohën e mëparshme (shih Nr. 2.2).

POR: Agjentura Federale e Punës nuk shqyrton më, nëse do të duhej që këtë vend pune ta marrin persona të tjerë (shqyrtim i përparësisë). Pra rriten shanset, për të marrë një lejë të zënies me punë.

2.4 Ju jeni tanimë që prej 4 vjetësh në Gjermani

Pra lejohet që ju të punoni, pa këtë që të bëhet më parë një shqyrtim nëpërmjet Agjunkturës Federale të Punës. Por ju DUHET të shkoni tek autoriteti për të huajt që të lini të regjistrohet në lejimin e qëndrimit tuaj shtesa

„lejohet zënia me punë“

Pa këtë udhëzim ju **NUK** lejohet të punoni.

Me anë të kësaj ju mund të ushtroni pra çdo punë ose mësim profesional.

Por për kaq gjatë sa ju keni një lejim qëndrimi, ju NUK lejohet të veproni si ndërmarrje (të vetëpunësuar), por keni nevojë GJITHMONË për një punëdhënës, i cili ju vendos juve në punë.

3. Nën cilat kushte paraprake mund të merrni ju një lejë për zënie me punë për një mësim profesional në një ndërmarrje?

Nëse ju jeni ende nën 3 muaj në Gjermani, nuk lejohet që ju të mos bëni ASNJË mësim profesional në një ndërmarrje.

Ju jeni tanimë që prej 3 muajsh në Gjermani, autoriteti për të huajt mund t'ju japë juve një lejë për zënie me punë për mësimin e një profesioni në një ndërmarrje, pa këtë që të bëhet më parë një shqyrtim nëpërmjet Agjunkturës Federale të Punës.

II. Informacionet e para për refugjatë me një leje durimi

Për ju vlejné të njëjtat rregulla si për azilkërkues me një lejim qëndrimi (**shih I**) me dy përjashtime:

1. Ndalim pune

Autoriteti për të huajt nuk ju jep juve asnjë lejë për zënie me punë, nëse ai është i pikëpamjes, që

- ju pengoni largimin tuaj me detyrim, p.sh. nëse ju jepni një identitet ose nënshtetësi të rremë ose ju nuk siguron një pasaportë udhëtimi ose një dokument zëvendësues pasaporte, pra p.sh. nuk udhëtoni për në ambasadën tuaj.
- Ju keni udhëtuar për në Gjermani vetëm për këtë, që të merrni mbështetje financiare nga autoritetet gjermane.

Në lejen e durimit atëhere qëndron:

„Veprimtaria e punës nuk lejohet“.

Nëse ju doni të shqyrtoni, nëse në rastin tuaj u vendos drejt dhe ju keni gjetur një vend pune, të cilin doni ta zini ju, do të duhej të drejtoheni në vendet e këshillimit, me qëllim që ky ndalim i mundshëm pune të hiqet.

2. Mësim profesioni në një ndërmarrje

Me një lejë durimi ju mund të merrni që në fillim një lejë zënieje me punë për një mësim profesioni në një ndërmarrje, pra ju nuk duhet të prisni pas hyrjes suaj tre muaj.

III. Informacionet e para për refugjatë me një leje qëndrimi

Nëse ju keni një **lejë qëndrimi**, qëndron në kartën tuaj çip, sipas cilit rregull, pra pse u dha leja e qëndrimit.

1. Leja e qëndrimit sipas nenit 22 fjalia 2; neni 23 paragrafi 2; neni 25 paragrafi 1, 2 ligji për qëndrim

Me këtë lejë qëndrimi lejohet që ju të punoni, të bëni një mësim profesioni ose të bëheni të vetëpunësuar. Për një veprimtari vetëpunësimi ju keni nevojë shpesh për leja të tjera, informohuni ju për këtë në një vend këshillimi.

Në lejen tuaj të qëndrimit për këtë arsye qëndron:

„Lejohet veprimtaria e punës“.

2. Leja e qëndrimit sipas nenit 22 fjalia 1; neni 23 paragrafi 1; neni 23a; neni 24; neni 25 paragrafi 3, 4, 4a, 4b, 5; neni 25a paragrafi 1, 2 ligji për qëndrim

Në rast të kësaj leje qëndrimi ju mund të ushtroni çdo punë ose mësim profesioni, por të mos bëheni menjëherë të vetëpunësuar. Shkoni ju prandaj tek autoriteti për të huajt, që ta regjistroni shtesën

„lejohet zënia me punë“.

në lejen tuaj të qëndrimit.

Dëshironi ju të bëheni i vetëpunësuar, duhet të bëni kërkesë për këtë tek autoriteti për të huajt për një lejë vetjake.



Netzwerk
Integration **NetwIn 2.0**

Herausgegeben vom
Caritasverband für die
Diözese Osnabrück e.V.
Dr. jur. Barbara Weiser
Knappsbrink 58
49080 Osnabrück
Email: bweiser@caritas-os.de



**INFORMACIONET E PARA PËR
HYRJEN NË TREGUN E PUNËS PËR
AZILKËRKUES
DHE REFUGJATË**

**Kur e marr unë një
leje zënieje me punë?**



Gefördert durch Mittel des: ESF-Bundesprogramms zur arbeitsmarktlichen Unterstützung für Bleibeberechtigte und Flüchtlinge mit Zugang zum Arbeitsmarkt II durch das Bundesministerium für Arbeit und Soziales und den Europäischen Sozialfonds.

Stand: 15.05.2015 / albanisch